



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3172/ 8 prot.

Datë 13.11.2025

V E N D I M
Nr. 1666/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13.11.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Asi 2A Co” SHPK & “Zdrava” SHPK, në procedurën e prokurimit “*Tender i Kufizuar (në kuadër të procesit të rindërtimit)*”, me Nr. REF-61906-09-18-2025, me objekt “*Rindërtimi i Godinës Nr.32, “Fakle”, Rruga “Teodor Rupi”*”, me fond limit 505,966,779 (pesëqind e pesë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 29.09.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës

Ankimues: Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Asi 2A Co” SHPK me NIPT K53002402C & “Zdrava” SHPK, me NIPT J84003411K dhe adresë: Rruga “Skëndërbeu”, Lagjia “Bishanake”, Pallati nr. 18, Hyrja Nr. 6, Fier.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Durrës.
Adresa: Sheshi “Liria”, Durrës.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, Ligji 97/2019 “*Për miratimin e aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019 të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore*”, neni 42 e vijues, Vendimi i Këshillit të

Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlëra limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi, se ankesat e operatorëve ekonomikë janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020, *“Për prokurimin publik”* dhe ligjin nr. 97/2020 *“Për miratimin e Akti Normativ me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”*, nenit 42 e vijues.

I.4. Ankimuesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 19.09.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit *“Tender i Kufizuar (në kuadër të procesit të rindërtimit)”*, me Nr. REF-61906-09-

18-2025, me objekt “Rindërtimi i Godinës Nr.32, “Fakle”, Rruga “Teodor Rupi”, me fond limit 505,966,779 (pesëqind e pesë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 29.09.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

II.2. Në datën 29.09.2025, autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e parë (shprehje interesi) të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, ku konstatohet se kanë shprehur interesin këto operatorë ekonomikë:

1. BOE “Lis Konstruksion” SHPK & “Viante Konstruksion” SHPK & “Llazo” SHPK
2. BOE “Inerti” SHPK & “Ed Konstriksion” SHPK
3. BOE “Asi 2A Co” SHPK & “Zdrava” SHPK

II.3. Në datën 13.10.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë, mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, (short listing) ku rezulton si më poshtë vijon:

BOE “Lis Konstruksion” SHPK & “Viante Konstruksion” SHPK & “Llazo” SHPK skualifikuar

BOE “Inerti” SHPK & “Ed Konstriksion” SHPK skualifikuar

BOE “Asi 2A Co” SHPK & “Zdrava” SHPK skualifikuar

II.4. Në datën 13.10.2025, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Lis Konstruksion” SHPK & “Viante Konstruksion” SHPK & “Llazo” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentin se:

Për kandidatin BOE “Lis Konstruksion” SH.P.K ME K66613407H + “Viante Konstruksion” SH.P.K K47103804L + “Llazo” SH.P.K K24218401K, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të kërkuar në fazën e parë konstatoi se:

Në lidhje me pikën e DT:

(2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit)

gj. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.)

Operatori “Llazo” SH.P.K, nuk ka paraqitur vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

Per sa me siper kjo pike nuk plotesohet.

Në lidhje me pikën e DT:

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional: 2.3.5 Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë përkatëse

si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

g. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1 (një) punonjës të pajisur me certificate të “Vlerësimi i ndikimit në mjedis” leshuar nga organe Ministria e Mjedisit., gjykohet si i domosdoshëm për realizimin e VNM (Vlerësimet e ndikimit në Mjedis) në fazën e realizimit të projektit të zbatimit. Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë: • Diplomë/certifikatë • Kontratë Pune të vlefshme.

Kandidati BOE “Lis Konstruksion” SH.P.K + “Viante Konstruksion” SH.P.K “Llazo” SH.P.K, nuk ka paraqitur asnjë punonjës të pajisur me certificate të “Vlerësimi i ndikimit në mjedis” leshuar nga organe Ministria e Mjedisit., gjykohet si i domosdoshëm për realizimin e VNM (Vlerësimet e ndikimit në Mjedis) në fazën e realizimit të projektit të zbatimit. Për sa me siper kjo pike nuk plotësohet.

Në lidhje me pikën e DT:

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë: Punonjes Staf Teknik - Teknik i mesëm Termohidraulik (Diplome e shkolles mesme) 1 (nje) Kandidati BOE “Lis Konstruksion” SH.P.K + “Viante Konstruksion” SH.P.K + “Llazo” SH.P.K, në lidhje me kërkesën për teknik të mesëm termohidraulik, operatori “Lis Konstruksion” SH.P.K” ka paraqitur një punonjës por pa diplomën e shkollës së mesme sic është kërkuar në DT. (Ka paraqitur një certifikatë formimi). Për sa me siper kjo pike nuk plotësohet.

Në lidhje me pikën e DT:

2.3 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim 2.4.1 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë licence lidhur me ndikimin në mjedis të leshuar nga QKL kodi III.2.B “Grumbullim dhe transportim i mbetjeve të llojeve të ndryshme” III.2.B “Grumbullim dhe transportim i mbetjeve të ujërave të ndotura urbane, llumrave septike dhe ujërave të zeza” duke përfshirë kodet 20 03 04, 19 13 04 ,19 13 06. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë licence kodi III.2.B sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes. Kandidati BOE “Lis Konstruksion” SH.P.K + “Viante Konstruksion” SH.P.K “Llazo” SH.P.K., në lidhje me kërkesën për licencën III.2.B ky bashkim operatorësh nuk disponon licencën III.2.B “Grumbullim dhe transportim i mbetjeve të ujërave të ndotura urbane, llumrave septike dhe ujërave të zeza” duke përfshirë kodet 20 03 04, 19 13 04 ,19 13 06. Për sa me siper kjo pike nuk plotësohet.

II.5. Në datën 15.10.2025 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. elektronik A/2025/5943 dhe me numër 2876/2025 prot., datë 16.10.2025, BOE “Lis Konstruksion” SHPK & “Viante Konstruksion” SHPK & “Llazo” SHPK, ku u konstatua, se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së tyre ekonomike, të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.6. Në datën 16.10.2025 Komsioni i Prokurimit Publik me vendimin nr. 1464/2025, vendosi pezullimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi si më poshtë:

1. *Të urdhërojë pezullimin e procedurës së prokurimit “Tender i Kufizuar (në kuadër të procesit të rindërtimit)”, me Nr. REF-61906-09-18-2025, me objekt: “Rindërtimi i Godinës Nr.32, “Fakle”, Rruga “Teodor Rupi”, me fond limit 505,966,779 (pesëqind e pesë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 29.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës, në procedurën e mësipërme të prokurimit dhe moskryerjen e asnjë veprimi nga autoriteti kontraktor deri në shqyrtimin e ankesës dhe marrjen e vendimit përfundimtar.*
2. *Autoriteti Kontraktor të dërgojë menjëherë pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave; të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimin e operatorit ekonomik ankimues, si dhe të gjithë materialet e paraqitura nga shoqëritë pjesëmarrëse.*
3. *I gjithë informacioni dhe dokumentacioni i kërkuar, të paraqitet jo më vonë se dita e nesërme e punës nga data e marrjes së këtij vendimi, dhe të jetë shoqëruar me një Proces-Verbal në të cilin të pasqyrohet emërtimi i dokumentave me numrin e fletëve përkatëse.*
4. *Për efekt shpejtësie në procesin e shqyrtimit administrativ, komunikimi dhe dërgimi i dokumentacionit të kërkuar më sipër, do të bëhet në mënyrë elektronike në adresën Kpp_info@kpp.gov.al.*
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.7. Në datën 13.10.2025, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Asi -2A Co” SHPK & “Zdrava” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentin se:

Për kandidatin BOE “Asi-2A Co” shpk me NIPT K53002402C + “Zdrava” sh.p.k me NIPT J84003411K , Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të kërkuar në fazën e parë konstatoi se:

Në lidhje me pikën e DT:

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme: - punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 252.500.000 Lek, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose - punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 1.010.000.000 Lek.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Kandidati BOE “Asi-2A Co” shpk + “Zdrava” sh.p.k, në lidhje me kërkesën për punë të ngjashme, përkatësisht operatori “Asi-2A Co” shpk ka paraqitur një kontratë për punë të

ngjashme me vlerë jo më të vogël se 252.500.000 Lek, që mban datën 10.12.2019 do të thotë që ka kaluar afatin 5 vite nga shpallja e kontratës sic kërkohet në DT. Nuk Ploteson punet e ngjashme.

Per sa me siper kjo pike nuk plotesohet.

II.8. Në datën 16.10.2025 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. elektronik A/2025/5944 dhe me numër 2880/2025 prot., datë 16.10.2025, BOE “Asi 2A Co” SHPK & “Zdrava” SHPK, ku u konstatua, se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së tyre ekonomike, të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.9. Në datën 16.10.2025 Komsioni i Prokurimit Publik me vendimin nr. 1465/2025, vendosi pezullimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi si më poshtë:

1. *Të urdhërojë pezullimin e procedurës së prokurimit “Tender i Kufizuar (në kuadër të procesit të rindërtimit)”, me Nr. REF-61906-09-18-2025, me objekt: “Rindërtimi i Godinës Nr.32, “Fakle”, Rruga “Teodor Rupi”, me fond limit 505,966,779 (pesëqind e pesë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 29.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës, në procedurën e mësipërme të prokurimit dhe moskryerjen e asnjë veprimi nga autoriteti kontraktor deri në shqyrtimin e ankesës dhe marrjen e vendimit përfundimtar.*
2. *Autoriteti Kontraktor të dërgojë menjëherë pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave; të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimin e operatorit ekonomik ankimues, si dhe të gjithë materialet e paraqitura nga shoqëritë pjesëmarrëse.*
3. *I gjithë informacioni dhe dokumentacioni i kërkuar, të paraqitet jo më vonë se dita e nesërme e punës nga data e marrjes së këtij vendimi, dhe të jetë shoqëruar me një Proces-Verbal në të cilin të pasqyrohet emërtimi i dokumentave me numrin e fletëve përkatëse.*
4. *Për efekt shpejtësie në procesin e shqyrtimit administrativ, komunikimi dhe dërgimi i dokumentacionit të kërkuar më sipër, do të bëhet në mënyrë elektronike në adresën Kpp_info@kpp.gov.al.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.10. Komisioni i Prokurimit Publik, në përputhje me Ligjin nr. 97/2020 “Për miratimin e Akti Normativ me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, për efekt shpejtësie në procesin e shqyrtimit administrativ, vendimin e mësipërm e ia dërgoi autoriteti kontraktor nëpërmjet postës elektronike në datë 16.10.2025, në adresat e

emalit të publikuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.11. Autoriteti kontraktor, është njoftuar nga Komisioni i Prokurimit Publik për dorëzimin e dokumentacionit të sipërpërmendur, nëpërmjet postës elektronike të publikuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, dhe ka dërguar informacionin e kërkuar të përcaktuar në vendimin Nr. 1464/2025, datë 16.10.2025 të KPP, të protokolluar me tonin me nr. 2876/4 prot., datë 20.10.2025, dhe vendimin Nr. 1465/2025, datë 16.10.2025 të KPP, të protokolluar me tonin me nr. 2880/5 prot., datë 20.10.2025.

II.12. Me datë 23.10.2025, me Vendimin nr. 1525/2025 Komisioni Prokurimit Publik vendosi:

1. *Të pranojë pjesërisht ankesën e BOE “Lis Konstruksion” SHPK & “Viante Konstruksion” SHPK & “Llazo” SHPK, për procedurën e prokurimit “Tender i Kufizuar (në kuadër të procesit të rindërtimit)”, me Nr. REF-61906-09-18-2025, me objekt “Rindërtimi i Godinës Nr.32, “Fakle”, Rruga “Teodor Rupi”, me fond limit 505,966,779 (pesëqind e pesë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 29.09.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.*
2. *Të pranojë ankesën e BOE “Asi 2A Co” SHPK & “Zdrava” SHPK, për procedurën e prokurimit “Tender i Kufizuar (në kuadër të procesit të rindërtimit)”, me Nr. REF-61906-09-18-2025, me objekt “Rindërtimi i Godinës Nr.32, “Fakle”, Rruga “Teodor Rupi”, me fond limit 505,966,779 (pesëqind e pesë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 29.09.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.*
3. *Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësimin e procedurës të procedurës së prokurimit objekt ankimi për operatorët ekonomik ankimues, në përputhje me konstatimet e këtij vendimi.*
4. *Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
5. *Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “Lis Konstruksion” SHPK & “Viante Konstruksion” SHPK & “Llazo” SHPK.*
6. *Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “Asi 2A Co” SHPK & “Zdrava” SHPK.*
7. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
8. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.13. Në datën 04.11.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë, mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, (short listing) ku rezulton si më poshtë vijon:

BOE “Lis Konstruksion” SHPK & “Viante Konstruksion” SHPK & “Llazo” SHPK skualifikuar

BOE “Inerti” SHPK & “Ed Konstriksion” SHPK skualifikuar

BOE “Asi 2A Co” SHPK & “Zdrava” SHPK skualifikuar

II.14. Në datën 04.11.2025, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Asi 2A Co” SHPK & “Zdrava” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentin se:

Për kandidatin BOE “ASI-2A CO” shpk me NIPT K53002402C + “Z D R A V A” sh.p.k me NIPT J84003411K, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të kërkuar në fazën e parë u konstatua se:

1. Pika 2.3.2. pasi në pikën a) Liçenca e zbatimit e paraqitur nga OE “ASI-2A CO” drejtuesja teknike Ermira Xhelilaj nuk është paraqitur në listë pagesë. Pikën b) Liçenca e Projektimit e paraqitur nga OE “ASI-2A CO” drejtuesja teknike Ermira Korçari dhe Adela Allkushi nuk janë përfshirë në list pagesë.

2. Pika 2.3.5. pasi në pikën h) Mjekët e paraqitur nga BOE 1-mjekja Tana Topia përfunduar afati i liçencës 25.09.2025. 2- mjeku Dhimitraq Dhimo nuk është paraqitur në list pagesat e shoqërisë.

3. Pika 2.3.6. pasi: sipas deklarimeve dhe dokumentacionit të paraqitur nga BOEnr.i duhur i punonjëve puntor ndërtimi të thjeshtë ndërsa Automakinisti Jetmir Marku i ka përfunduar DPA datë. 10.09.2025 ndërsa Ariol Dervishi nuk ka çertifikat të sigurimit teknik.

4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim Pika 2.4.1. pasi: nuk është paraqitur nga OE Zdrava Liçenca III.2.B “Grumbullim dhe transportim i mbetjeve të ujrave të ndotura urbane, llumrave septike dhe ujrave të zeza “ duke përfshir kodet 20 03 04, 19 03 04, 19 13 06. Duke u referuar tek marrveshja e bashkëpunimit ku përfshihen të gjitha zerrat e preventivit pasi punimet janë ndarë në përqindje 49% me 51%, si dhe referuar DST (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë licence kodi III.2.B sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.).

5. Pika 2.3.5. pasi: për materialin hekur, materialet elektrike dhe hidraulike autorizimi i distributorit nuk është paraqitur sipas formatit të kërkuar në DST ku: Autorizimi/Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbaj të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, ëbsite e nevojëshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve.

6. Pika 2.4.4: BOE “ASI-2A CO” shpk me NIPT K53002402C + “Z D R A V A” sh.p.k me NIPT J84003411K kanë në proçest 11 kontrata.

II.15. Në datën 05.11.2025 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. elektronik A/2025/6052 dhe me numër 3172/2025 prot., datë 06.11.2025, BOE “Asi 2A Co” SHPK & “Zdrava” SHPK, ku u konstatua, se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së tyre ekonomike, nga procedura e prokurimit objekt-ankimi.

II.16. Në datën 07.11.2025 Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin nr. 1624/2025, vendosi pezullimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi si më poshtë:

1. *Të urdhërojë pezullimin e procedurës së prokurimit “Tender i Kufizuar (në kuadër të procesit të rindërtimit)”, me Nr. REF-61906-09-18-2025, me objekt: “Rindërtimi i Godinës Nr.32, “Fakle”, Rruga “Teodor Rupi”, me fond limit 505,966,779 (pesëqind e pesë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 29.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës, në procedurën e mësipërme të prokurimit dhe moskryerjen e asnjë veprimi nga autoriteti kontraktor deri në shqyrtimin e ankesës dhe marrjen e vendimit përfundimtar.*
2. *Autoriteti Kontraktor të dërgojë menjëherë pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave; të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimin e operatorit ekonomik ankimues, si dhe të gjithë materialet e paraqitura nga shoqëritë pjesëmarrëse.*
3. *I gjithë informacioni dhe dokumentacioni i kërkuar, të paraqitet jo më vonë se dita e nesërme e punës nga data e marrjes së këtij vendimi, dhe të jetë shoqëruar me një Proces-Verbal në të cilin të pasqyrohet emërtimi i dokumentave me numrin e fletëve përkatëse.*
4. *Për efekt shpejtësie në procesin e shqyrtimit administrativ, komunikimi dhe dërgimi i dokumentacionit të kërkuar më sipër, do të bëhet në mënyrë elektronike në adresën Kpp_info@kpp.gov.al.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.17. Komisioni i Prokurimit Publik, në përputhje me Ligjin nr. 97/2020 “Për miratimin e Akti Normativ me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, për efekt shpejtësie në procesin e shqyrtimit administrativ, vendimin e mësipërm e ia dërgoi autoriteti kontraktor nëpërmjet postës elektronike në datë 10.11.2025, në adresat e emailit të publikuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.18. Autoriteti kontraktor, është njoftuar nga Komisioni i Prokurimit Publik për dorëzimin e dokumentacionit të sipërpërmendur, nëpërmjet postës elektronike të publikuar nga autoriteti

kontraktor në dokumentat e tenderit, dhe ka dërguar informacionin e kërkuar të përcaktuar në vendimin Nr. 1624/2025, datë 07.11.2025 të KPP, të protokolluar me tonën me nr. 3172/5 prot., datë 11.11.2025.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e BOE “Asi 2A Co” SHPK & “Zdrava” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se procedura e shqyrtimit administrativ të ankesës së operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik rregullohet nga ligji nr. 97/2019 “Për miratimin e Aktit Normativ me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”.

III.1.1. Neni 42 pika 10 i ligjit nr. 97/2019 “Për miratimin e Akti Normativ me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, parashikon shprehimisht se: “10. Pas afatit për paraqitjen e kërkesave për pjesëmarrje, siç përcaktohet në njoftimin e kontratës, autoriteti kontraktor përzgjedh kandidatët brenda 10 ditëve kalendarike. Kundër vendimit të autoritetit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve paraqitet ankim administrativ pranë KPP-së, brenda 3 ditëve nga njoftimi i kandidatëve fitues. KPP-ja shqyrton ankesën dhe merr vendim brenda 5 ditëve nga data e depozitimit të ankesës, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative dhe të këtij akti. Për efekt kohe, komunikimi midis Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor bëhet nëpërmjet e-mail-it zyrtar. Me kalimin e këtij afati, nëse KPP-ja nuk është shprehur me vendim, autoriteti kontraktor vijon me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.”.

III.1.2. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Asi 2A Co” SHPK & “Zdrava” SHPK, në zbatim të nenit 29, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, në të cilin parashikohet se “1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përfundimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre”, nisur nga arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesës ka lidhje me vendimet dhe veprimet e ndërmarra kryesisht nga autoritetit kontraktor, komisioni vlerësimit të ofertave gjatë zbatimit të hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

III.1.3. Lidhur me pretendimin e BOE “Asi 2A Co” SHPK & “Zdrava” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij, me argumentimin se: *Për kandidatin BOE “ASI-2A CO” shpk me NIPT K53002402C + “Z D R A V A” sh.p.k me NIPT J84003411K, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të kërkuar në fazën e parë u konstatua se: 1. Pika 2.3.2. pasi në pikën a) Liçenca e zbatimit e paraqitur nga OE “ASI-2A CO” drejtuesja teknike Ermira Xhelilaj nuk është paraqitur në listë pagesë. Pikën b) Liçenca e Projektimit e paraqitur nga OE “ASI-2A CO” drejtuesja teknike Ermira Korçari dhe Adela Allkushi nuk janë përfshirë në listë pagesë. 2. Pika 2.3.5. pasi në pikën h) Mjekët e paraqitur nga BOE 1-mjekja Tana Topia përfunduar afati i liçencës 25.09.2025. 2- mjeku Dhimitraq Dhimo nuk është paraqitur në listë pagesat e shoqërisë. 3. Pika 2.3.6. pasi: sipas deklarimeve dhe dokumentacionit të paraqitur nga BOEnr.i duhur i punonjëve puntor ndërtimi të thjeshtë ndërsa Automakinisti Jetmir Marku i ka përfunduar DPA datë. 10.09.2025 ndërsa Ariol Dervishi nuk ka çertifikat të sigurimit teknik. 4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim Pika 2.4.1. pasi: nuk është paraqitur nga OE Zdrava Liçenca III.2.B “Grumbullim dhe transportim i mbetjeve të ujrave të ndotura urbane, llumrave septike dhe ujrave të zeza “ duke përfshir kodet 20 03 04, 19 03 04, 19 13 06. Duke u referuar tek marrveshja e bashkëpunimit ku përfshihen të gjitha zerat e preventivit pasi punimet janë ndarë në përqindje 49% me 51%, si dhe referuar DST (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë licence kodi III.2.B sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.). 5. Pika 2.3.5. pasi: për materialin hekur, materialet elektrike dhe hidraulike autorizimi i distributorit nuk është paraqitur sipas formatit të kërkuar në DST ku: Autorizimi/Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbaj të dhëna të plota të prodhuesit si:Telefon, fax, e-mail,ëbsite e nevojëshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve. 6. Pika 2.4.4: BOE “ASI-2A CO” shpk me NIPT K53002402C + “Z D R A V A” sh.p.k me NIPT J84003411K kanë në proçest 11 kontrata”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:*

III.1.4. Në datën 04.11.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë, mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, (short listing) ku rezulton si më poshtë vijon:

BOE “Lis Konstruksion” SHPK & “Viante Konstruksion” SHPK & “Llazo” SHPK skualifikuar

BOE “Inerti” SHPK & “Ed Konstriksion” SHPK skualifikuar

BOE “Asi 2A Co” SHPK & “Zdrava” SHPK skualifikuar

III.1.5. Në datën 04.11.2025, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Asi 2A Co” SHPK & “Zdrava” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentin se:

Për kandidatin BOE “ASI-2A CO” shpk me NIPT K53002402C + “Z D R A V A” sh.p.k me NIPT J84003411K, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të kërkuar në fazën e parë u konstatua se:

1. Pika 2.3.2. pasi në pikën a) Liçenca e zbatimit e paraqitur nga OE “ASI-2A CO” drejtuesja teknike Ermira Xhelilaj nuk është paraqitur në listë pagesë. Pikën b) Liçenca e Projektimit e paraqitur nga OE “ASI-2A CO” drejtuesja teknike Ermira Korçari dhe Adela Allkushi nuk janë përfshirë në list pagesë.

2. Pika 2.3.5. pasi në pikën h) Mjekët e paraqitur nga BOE 1-mjekja Tana Topia përfunduar afati i liçencës 25.09.2025. 2- mjeku Dhimitraq Dhimo nuk është paraqitur në list pagesat e shoqërisë.

3. Pika 2.3.6. pasi: sipas deklarimeve dhe dokumentacionit të paraqitur nga BOEnr.i duhur i punonjëve puntor ndërtimi të thjeshtë ndërsa Automakinisti Jetmir Marku i ka përfunduar DPA datë. 10.09.2025 ndërsa Ariol Dervishi nuk ka çertifikat të sigurimit teknik.

4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim Pika 2.4.1. pasi: nuk është paraqitur nga OE Zdrava Liçenca III.2.B “Grumbullim dhe transportim i mbetjeve të ujrave të ndotura urbane, llumrave septike dhe ujrave të zeza “ duke përfshir kodet 20 03 04, 19 03 04, 19 13 06. Duke u referuar tek marrveshja e bashkëpunimit ku përfshihen të gjitha zerrat e preventivit pasi punimet janë ndarë në përqindje 49% me 51%, si dhe referuar DST (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë licence kodi III.2.B sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.).

5. Pika 2.3.5. pasi: për materialin hekur, materialet elektrike dhe hidraulike autorizimi i distributorit nuk është paraqitur sipas formatit të kërkuar në DST ku: Autorizimi/Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbaj të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, ëbsite e nevojëshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve.

6. Pika 2.4.4: BOE “ASI-2A CO” shpk me NIPT K53002402C + “Z D R A V A” sh.p.k me NIPT J84003411K kanë në proçest 11 kontrata.

III.1.6. Në datën 05.11.2025 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. elektronik A/2025/6052 dhe me numër 3172/2025 prot., datë 06.11.2025, BOE “Asi 2A Co” SHPK & “Zdrava” SHPK, ku u konstatua, se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së tyre ekonomike, nga procedura e prokurimit objekt-ankimi.

III.1.7. Në datën 07.11.2025 Komsioni i Prokurimit Publik me vendimin nr. 1624/2025, vendosi pezullimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi si më poshtë:

1. Të urdhërojë pezullimin e procedurës së prokurimit “Tender i Kufizuar (në kuadër të procesit të rindërtimit)”, me Nr. REF-61906-09-18-2025, me objekt: “Rindërtimi i Godinës Nr.32, “Fakle”, Rruga “Teodor Rupi”, me fond limit 505,966,779 (pesëqind e pesë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 29.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës, në procedurën e mësipërme të prokurimit dhe moskryerjen e asnjë veprimi nga autoriteti kontraktor deri në shqyrtimin e ankesës dhe marrjen e vendimit përfundimtar.

2. *Autoriteti Kontraktor të dërgojë menjëherë pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave; të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimin e operatorit ekonomik ankimues, si dhe të gjithë materialet e paraqitura nga shoqëritë pjesëmarrëse.*
3. *I gjithë informacioni dhe dokumentacioni i kërkuar, të paraqitet jo më vonë se dita e nesërme e punës nga data e marrjes së këtij vendimi, dhe të jetë shoqëruar me një Proces-Verbal në të cilin të pasqyrohet emërtimi i dokumentave me numrin e fletëve përkatëse.*
4. *Për efekt shpejtësie në procesin e shqyrtimit administrativ, komunikimi dhe dërgimi i dokumentacionit të kërkuar më sipër, do të bëhet në mënyrë elektronike në adresën Kpp_info@kpp.gov.al.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik, në përputhje me Ligjin nr. 97/2020 “Për miratimin e Akti Normativ me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, për efekt shpejtësie në procesin e shqyrtimit administrativ, vendimin e mësipërm e ia dërgoi autoriteti kontraktor nëpërmjet postës elektronike në datë 10.11.2025, në adresat e emailit të publikuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III.1.9. Autoriteti kontraktor, është njoftuar nga Komisioni i Prokurimit Publik për dorëzimin e dokumentacionit të sipërpërmendur, nëpërmjet postës elektronike të publikuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, dhe ka dërguar informacionin e kërkuar të përcaktuar në vendimin Nr. 1624/2025, datë 07.11.2025 të KPP, të protokolluar me tonën me nr. 3172/5 prot., datë 11.11.2025.

III.1.10. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

III.1.11. Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.1.12. Në udhëzimin nr. 07, datë 30.07.2021 “Për mënyrën e zhvillimit të procedurave të prokurimit me mjete elektronike”, parashikohet shprehimisht se:

Pas përfundimit të procesit të vlerësimit nga të gjithë anëtarët e KVO për të gjitha ofertat e dorëzuara nga operatorët ekonomikë, anëtari i autorizuar i njësisë së prokurimit duhet të bëjë në sistem mbylljen e fazës së vlerësimit të ofertave në sistem. Në këtë moment sistemi iu dërgon në mënyrë elektronike automatikisht njoftimin mbi klasifikimin e gjithë operatorëve ekonomikë pjesëmarrës.

III.1.13. Në nenin 80 pika 1, 2, 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se:” përcaktohet se:

“1. Kontratat jepen mbi bazën e kriterëve të përcaktuara, pasi autoriteti ose enti kontraktor të ketë verifikuar që janë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) oferta përmbush kërkesat, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin e kontratës ose në ftesën për ofertë dhe në dokumentet e tenderit, duke marrë në konsideratë, sipas rastit, variantet e paraqitura;

b) operatori ekonomik, që ka dorëzuar ofertën, përmbush kriteret e kualifikimit e të përzgjedhjes dhe nuk ndodhet në ndonjë nga situatat që përbëjnë shkak për skualifikim.

2. Autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin refuzimin e ofertës, pavarësisht vlerës së saj, nëse vlerësohet se oferta e paraqitur nuk është në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i legjislacionit vendas, marrëveshjeve ndërkombëtare ose legjislacionit vendas në fushën e mjedisit, mbrojtjes shoqërore dhe punës.

3. Autoritetet ose entet kontraktore i shqyrtojnë ofertat e paraqitura bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga operatorët ekonomikë dhe legjislacionin përkatës në fuqi.”

III.1.14. Në nenin 82 pika 1 dhe 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar përcaktohet se:

1. Kohëzgjatja e procedurës së vlerësimit nuk duhet të kalojë 20 (njëzet) ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe 15 (pesëmbëdhjetë) ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar, përveç rasteve të tjera të cilësuara ndryshe në këto rregulla.

Në rast se komisionit të vlerësimit të ofertave i lind nevoja për verifikime ose ndryshime të një apo më shumë anëtarëve, afati i vlerësimit pezullohet në momentin e paraqitjes së kërkesës për verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku është pezulluar, me marrjen e përgjigjes apo zyrtarizimit të anëtarit/anëtarëve.

2. Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:

- i. “Devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit;
- ii. “Rezervimi” është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe
- iii. “Mospranimi” është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit.

Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë.”.

III.1.15. Në rastin konkret, nisur nga arsyet e skualifikimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Asi 2A Co” SHPK & “Zdrava” SHPK, si dhe pretendimet e këtij të fundit të parashtruar në ankesë, KPP vëren, se momenti procedural i vlerësimit të dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik mbi kriteret e kualifikimit, duhet të ishte data 13.10.2025, datë në të cilën referuar dhe sistemit prokurimeve elektronike rezulton të jetë përmbyllur dhe procesi i vlerësimit të ofertave nga ana komisionit të vlerësimit të ofertave, ku për bashkimin e operatorëve ekonomik ankimues është dhënë tjetër arsye skualifikimi, nga ajo e rivlersimit të datës 04.11.2025. Arsye për të cilën bashkimi i operatorëve ekonomik ankimues pas ankesës së bërë në datë 16.10.2025 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, Komisioni Prokurimit Publik u shpreh me vendimin nr. 1525/2025, datë 23.10.2025 duke vendosur pranimin e ankesës me arsyetimin se “KPP gjykon, se autoriteti kontraktor **nuk duhet të gjykojë në mënyrë sipërfaqësore e formale**, por të analizojë në themel dhe në mënyrë të arsyeshme e proporcionale eksperiencat e dokumentuara nga ofertuesit/kandidatët, në funksion të qëllimit dhe rrethanave faktike për të cilin vendosen kriteret e përcaktuara. Pra, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk ka vlerësuar në mënyrë të drejtë një nga komponentët, e cila është komponenti kohë, (e cila është edhe arsyeja e skualifikimit të dhënë nga AK), pra e dëshmime të eksperiencës së ngjashme të dorëzuar nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomike ankimues. Pasi, referuar faturave tatimore të lëshuara dhe situacioneve mujore, në të cilat janë kryer punimet, rezultojnë të jenë brenda afatit 5 vjeçar nga data e njoftimit të kontratës, të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Në këto kushte, Komisioni gjykon se, autoriteti kontraktor duhte të marrë masa që të rivlerësojë në mënyrë të drejtë dhe konformë vetë kriterit të hartuar për përmbushjen e dëshmisë për përvojën e mëparshme të ngjashme duke iu referuara faturave tatimore të realizuara gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës”. Pra jo më kot ligjvënësi, në varësi të llojit të procedurës, ka parashikuar një afat

kohor (20 ose 15 ditë) për procesin e vlerësimit të ofertave duke dhënë garanci për secilën prej palëve, si për KVO-në nga njëra anë për kryerjen e një vlerësimi të thelluar e transparent dhe me mundësinë edhe të kryerjes së verifikimeve pranë palëve të treta ose sqarimeve nga operatorët ekonomikë sa herë lind nevoja, ashtu dhe për operatorët ekonomikë pjesëmarrës që pas procesit të vlerësimit të ofrave dhe publikimit të njoftimit të fituesit paraprak apo anulimit të procedurës të kenë mundësi të mbrojnë interesat e ligjshëm duke ushtruar të drejtën e ankimit në autoritet kontraktor dhe në KPP. Në këtë kuadër KPP gjykon, se brenda periudhës kohore që ligji parashikon, KVO e autoritetit kontraktor ka patur në dispozicion momentin procedural për kryerjen e verifikimeve të të gjithë dokumentacionit të ngarkuar në SPE nga ky bashkim operatorësh apo kërkimin e sqarimeve të nevojshme për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit, derisa të konkludonte me mbylljen e procesit të vlerësimit në sistemin e prokurimit elektronik me datë 13.10.2025, ku bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Asi 2A Co” SHPK & “Zdrava” SHPK ka rezultuar i skualifikuar për mospërmbushje të kriterit 2.3.1 përvojat e mëparshme të ngjashme.

Pra për vlerësuar të gjithë dokumentet e ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, KVO e autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural deri me datë 13.10.2025, kur ka përfunduar procesi i vlerësimit në SPE dhe njoftimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës mbi vlerësimin për t’u shprehur në lidhje me përputhshmërinë e tyre me kriteret për kualifikim të përcaktuar në dokumentet e tenderit. Legjislacioni i prokurimit publik e përcakton në mënyrë të qartë që një ofertë konsiderohet e vlefshme vetëm nëse ajo përmbush të gjitha kërkesat për kualifikim, fakt të cilin KVO e autoritetit kontraktor e ka shprehur me vlerësimin e datës 13.10.2025, ku bashkimi i operatorëve ekonomikë “Asi 2A Co” SHPK & “Zdrava” SHPK ka rezultuar i skualifikuar për mospërmbushje të kriterit të përvojës së mëparshme të ngjashme. KPP gjykon, se ligjvënësi ka përcaktuar një procedurë të caktuar për t’u ndjekur nga ana e autoriteteve kontraktore në procesin e vlerësimit të ofertave dhe vetëm në rastet e deklarimeve të paraqitura në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të ngarkuar në SPE dhe që shërbejnë si provë paraprake vlerësimi, KVO e autoritetit kontraktor me dokumentacionin e dorëzuar në rrugë shkesore mund të verifikojë përputhshmërinë e deklarimeve të paraqitura në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar në rrugë shkresore, cdo dokument tjetër për përmbushjen e kriterëve kualifikuese që nuk përmbushet nëpërmjet formularit përmbledhës të vetëdeklarimit duhet të verifikohet dhe të vlerësohet deri në momentin e njoftimit të klasifikimit, çdo vlerësim apo rivlerësim i mëvonëshëm ndaj këtyre dokumentave pas momentit procedural të parashikuar nga ligjvënësi do të konsiderohet nul.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, në nenin 2 të tij, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Gjithashtu KPP gjykon, se ligjvënësi ka parashikuar afate strikte kohore për zhvillimin

e procedurave të prokurimit në përgjithësi dhe në veçanti në lidhje me institutin e ankimit administrativ, të rishikimit të vendimmarrjes së autoritetit kontraktor.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se rivlerësimi i datës 04.11.2025 në lidhje me arsyet e reja të skualifikimit për bashkimin e operatorëve ekonomikë ankimues “Asi 2A Co” SHPK & “Zdrava” SHPK, do të konsiderohen si akt absolutisht i pavlefshme, pasi komisioni vlerësimi të ofertave moment procedural për tu shprehur në lidhje me përmbushjen apo mospërmbushjen e kriterëve kualifikuese të hartuara nga autoriteti kontraktor e ka patur në datën 13.10.2025, moment të cilin komisioni vlerësimi të ofertave nuk e ka shfrytëzuar edhe pse bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues dokumentacionin e ka patur të ngarkuar në sistem e prokurimeve elektronike. Në nenin 108 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikon se “*Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm në rastet e mëposhtme: a) kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi lidhur me: i) kompetencën e organit publik; ii) procedurën e nxjerrjes së tij; ose iii) formën ose elementë të tjerë të detyrueshëm të aktit; b) është nxjerrë nëpërmjet mashtrimit, kanosjes, mitmarrjes, konfliktit të interesit, falsifikimit apo një veprimi tjetër që përbën vepër penale; c) ekzekutimi i aktit mund të shkaktojë një veprim të dënueshëm, sipas legjislacionit penal; ç) në çdo rast tjetër të parashikuar shprehimisht në ligj.*” Gjithashtu, në nenin 111 të K.Pr.A parashikohet se “*Organi publik ka detyrimin të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ nëse vjen në dijeni për rastet e parashikuara në nenin 108 të këtij Kodi*”. Ndër karakteristikat thelbësore të veprimit juridik absolutisht të pavlefshëm përmendim: (i) *veprimi juridik që është absolutisht i pavlefshëm nuk shkakton pasojat juridike që synojnë palët; (ii) ai nuk ka fuqinë juridike të një veprimi juridik të vlefshëm; (iv) veprimi juridik i pavlefshëm nuk mund të bëhet i vlefshëm me asnjë veprim të mëpasshëm, as edhe kur ekziston vullneti i palëve (me aprovim, miratim), as me kalimin e kohës së parashkrimit dhe as me zhdukjen më vonë të shkakut të pavlefshmërisë (quod ab initio vitiosum est tractu temporis convalescere non potest).* Komisioni i Prokurimit Publik në interpretim sistematik (domethënien e drejtë të normës juridike, duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik), gjykon, se ndodhet para kushtit të konstatimit prima facia të një akti administrativ absolutisht të pavlefshëm dhe në cilësinë e organit administrativ më të lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, parashikuar nga neni 24/1 i ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*”, konstaton se akti administrativ i Komisionit Vlerësimi të Ofertave për skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Asi 2A Co” SHPK & “Zdrava” SHPK me arsye të reja skualifikimi, do të konsiderohet një akte administrative absolutisht i pavlefshme në kuptim të nenit 108 të K.Pr.A, dhe në tejkalim të arsyetimit të vendimit nr. 1525/2025, datë 23.10.2025 të Komisionit Prokurimit Publik. Sa më sipër, referuar nenit 110 të KPrA në të cilën parashikohet se “*Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë. Ai konsiderohet se nuk ekziston.*”, autoriteti kontraktor duhet të marrë masat për kthimin e situatës juridike në gjendjen fillestare për operatorin ekonomik ankimues “Asi 2A Co” SHPK & “Zdrava” SHPK, duke kryer rivlersimin e këtij bashkimi operatorësh ekonomik sipas përcaktimeve të bëra nga Komisioni Prokurimit Publik në vendimin nr. 1525/2025, datë 23.10.2025. KPP gjykon, se ligjvënësi ka përcaktuar një procedurë të caktuar për t’u ndjekur nga ana e autoriteteve/enteve kontraktore në procesin e vlerësimit të ofertave, si në aspektin kohor ashtu dhe në atë procedural. Në rastin

konkret KPP e gjykon të gabuar, si zbatimin ashtu dhe interpretimin e ligjit ana e KVO-së së autoritetit kontraktor. Pasi autoriteti kontraktor ka patur në dispozicion momentin procedural deri me datë 13.10.2025, kur ka përfunduar procesi i vlerësimit në SPE dhe njoftimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës mbi vlerësimin për t'u shprehur në lidhje me përputhshmërinë e dokumenteve të operatorit ekonomik në SPE me kriteret për kualifikim të përcaktuar në dokumentet e tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se hapat procedurale të ndjekur nga autoriteti kontraktor për procedurën e prokurimit objekt-prokurimi cenojnë në thelb jo vetëm garancitë procedurale të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, por njëherazi cenojnë edhe parimin e sigurisë juridike. Në jurisiprudencën e saj *Inter Allia*, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në vendimin nr. 12/2014 datë 17.03.2014 është shprehur se *“Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit tek shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin”*. Sa më sipër, KPP gjykon, se në rastin konkret parimi i sigurisë juridike në kuptimin material të tij, konsiderohet edhe moscenimi i të drejtave të fituara dhe i pritshmërive të ligjshme që garantojnë aktet në fuqi. Akoma më tej, në jurisiprudencën e saj, Gjykata Kushtetuese *Inter Allia* në vendimin 15/2010 ka theksuar se *“parimi i shtetit të së drejtës i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës nënkupton veprimin e të gjithë institucioneve shtetërore sipas së drejtës në fuqi si dhe supremacinë e Kushtetutës ndaj akteve të tjera normative. Çdo organ në një shtet të së drejtës duhet të veprojë për atë që i lejon Kushtetuta dhe ligji duke mos i tejkaluar kufijtë e përcaktuar prej tyre. Në këtë kuptim, çdo institucion shtetëror duhet të ketë të përcaktuar qartë fushën e kompetencave të veta brenda të cilave është i autorizuar të veprojë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore”*.

Sa më sipër, KPP gjykon, se arsyet e reja të skualifikimit të dhëna për bashkimin e operatorëve ekonomikë ankimes janë kryer në shkelje të parashikimeve ligjore dhe akteve nënligjore në fuqi lidhur me momentin procedural të verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar në SPE. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor për procedurat e prokurimit të cilat realizon, duhet të garantojë respektimin e parashikimeve ligjore në fuqi dhe parimeve të transparencës dhe efikasitetit parashikuar në nenin 2 të LPP-së.

Rrjedhimisht pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimes qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Ligji 97/2019 “Për miratimin e aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019 të këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, neni 42 e vijues Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e BOE “Asi 2A Co” SHPK & “Zdrava” SHPK, për procedurën e prokurimit “Tender i Kufizuar (në kuadër të procesit të rindërtimit)”, me Nr. REF-61906-09-18-2025, me objekt “Rindërtimi i Godinës Nr.32, “Fakle”, Rruga “Teodor Rupi”, me fond limit 505,966,779 (pesëqind e pesë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 29.09.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësimin e procedurës të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në përputhje me konstatimet e këtij vendimi.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “Asi 2A Co” SHPK & “Zdrava” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

